
Paralajmërim udhëtimi

për në Shqipëri, Bosnjë - Hercegovinë, Bullgari, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Republikën e Moldavisë, Rumani, Serbi, Turqi

Për shkak të rritjes së dukshme të shifrave të të infektuarve nga COVID-19, Ministria e Jashtme Austriake lëshoi me datë 1.7.2020, si dhe me datë 8.7.2020, një **paralajmërim udhëtimi** (niveli i sigurisë 6) për **vendet në vijim**:

- Shqipëri,
- Bosnjë - Hercegovinë,
- Bullgari
- Kosovë,
- Mali i Zi,
- Maqedoni e Veriut,
- Republika e Moldavisë,
- Rumani,
- Serbi

Gjithashtu vazhdon të vlejë paralajmërimi i udhëtimit për **Turqinë** (niveli i sigurisë 6).

Në këto vende ekziston një rrezik i lartë infektimi me koronavirus dhe si vijim një rrezik mjaft i lartë shëndetësor për udhëtarët dhe njerëzit në mjedisin e tyre. Prandaj paralajmërohet shprehimisht që të mos ndërmerren udhëtime në këto vende.

Të gjitha informacionet e udhëtimit gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme: www.aussenministerium.at

Kur austriaket/ët ose personat nga vendet e treta me vendbanim apo leje qëndrimi në Austri dëshirojnë të hyjnë në Austri duke ardhur nga këto vende, ato/ata duhet të mbajnë pa përjashtim me vete një certifikatë mjekësore, e cila konfirmon një rezultat negativ të testit ndaj SARS-CoV-2 dhe nuk është më e vjetër se 4 ditë.

Nëse një certifikatë e tillë nuk mund të paraqitet gjatë kontrollit të hyrjes, personi duhet t'i nënshtrohet një karantine 14-ditore në shtëpi, e cila mund të përfundojë para kohe vetëm nëse paraqitet rezultati negativ i testit në fjalë. Respektimi i karantinës kontrollohet nga autoritetet.